



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:003522

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05620735

**C-IV.-14-4796**

*Ankuesi:*

**Sh G** nga Hajvalia.

*Përfaqësuar nga B B avokat nga Prishtina.*

**Kundër**

*Pala kundërshtare:*

**N.SH “Amortizatorët”**, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc.Murat Hulaj, me dt.25 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankuesit dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.PRN047-1116 të dt.15 maj 2014.
- Në këtë çështje nuk caktohen taksa gjyqësore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me dt.17 qershor 2014, ankuesi kishte paraqitur kërkesë për rishikim të vendimit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr.PRN047-1116 të dt.15 maj 2014, me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,246.00€, nga N.SH “Amortizatorët” (në likuidim). Ankuesi në ankesë ka pohuar se ankesën e paraqet për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka shtuar se AKP e ka nxjerr njoftimin e kundërligjshëm për ndërprerje të marrëdhënie të punës, kurse pagat iu kanë mbetur të pa paguara, dhe se me ligj sanksionohen rastet kur punëtori gëzon të drejtën e kompensimit të pagës dhe kompensimeve të tjera. Ankuesi nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë.

Gjykata, duke vepruar sipas kësaj lëndë me dt.20 tetor 2021, ka lëshuar një urdhër për ankuesin, përmes të cilit ka kërkuar që të bëjë dorëzimin e kopjes së vendimit të atakuar. I njëjti i është përgjigjur me dt.04 nëntor 2021, me të cilin ka dorëzuar kopjen e vendimit të kundërshtuar.

E paditura me dt.11 mars 2024, e ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ja bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Objekti i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit. Vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe nuk ka bazë ligjore për ta shfuqizuar të njëjtin. Ka shtuar se kërkesa do të duhej të ishte paraqitur në ndonjë gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri viteve, nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos i ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtrueses. Ka kërkuar që ankesa e ankueses të refuzohet si të pa pranueshme dhe të pa bazuar.

Me dt.03 prill 2024, ka lëshuar një urdhër për ankuesin përmes të cilit ka kërkuar nga i njëjti që të bëjë dorëzimin e librezës së punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës në emrin e ankueses, listën e pagave të cilat dëshmon se ankuesi ka pranuar si dhe prova tjera me të cilat i mbështet pretendimet ankimore. Ankuesi e ka pranuar të njëjtin dhe me dt.17 prill 2024, përmes të autorizuarit të tij është drejtuar gjykatës me parashtrësë duke bërë dorëzimin e këtyre provave: Kopjen e librezës së punës, kopjen e vendimit nr.8501 dt.28.09.1990, Kundërshtimin e dt.05.01.1990, si dhe një shkresë me dorëshkrim në një fletë të formatit A4 të dt.15.04.2024.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e ankuesit refuzohet si e papabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL-së.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Ankuesi së bashku me ankesë dhe përmes parashtresës ka bërë dorëzimin e kopjes së vendimit të kundërshtuar, kopjen e librezës së punës, kopjen e vendimit nr.8501 dt.28.09.1990, Kundërshtimin e dt.05.1.1990, si dhe një shkresë me dorëshkrim ne një fletë te formatit A4 te dt.15.04.2024.

. Pra, ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me të cilat do të bënte të besueshme se të njëjtit i takon kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, ashtu që ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij në tërësi.

Vendimi i Autoritetit të Likuidimit si dhe provat tjera të dorëzuara nga ankuesi së bashku me ankesë si dhe përmes parashtresës nuk mund të shërbejnë si prova të vetme për ti njohur të drejtën e pretenduar në ankesë. Ankuesi e ka bërë dorëzimin e librezës së punës, përmes të cilës vërtetohet se ankuesi kishte ofruar shërbime për NSH-në por ankuesi nuk bërë dorëzimin e provave të tjera me të cilat do të dëshmonte, se kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës, se sa ka qenë paga mujore të cilën ankuesi e kishte përfituar nga ndërmarrja. Andaj këto prova nuk vërtetuan në tërësi kërkesën e tij. Provat të cilat i ka dorëzuar dorëzoi nuk e vërtetojnë se të njëjtit NSH i ka mbetur borxh kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata gjen se në mungesë të dëshmimeve, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij të pretenduar, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla ankesa e ankuesit është refuzuar si e pabazuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par..4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore:**

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bartë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore me dt.04 nëntor 2021.

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**G j y q t a r i,**  
**Dr.sc.Murat Hulaj**